

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT  
 DHE SPORTIT  
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

## MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE 2024

Lënda: FILOZOFI DHE SOCIOLOGJI

### Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim dhe arsytim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7
Pikët							
Kërkesa	8	9	10	11	12	13	14
Pikët							
Kërkesa	15	16	17	18	19	20	21
Pikët							
Kërkesa	22	23	24	25	26	27	28
Pikët							
Kërkesa	29	30	31	32	33		
Pikët							

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

---

## **Sociologji**

1. Sipas Kanunit, gruas së divorcuar i pritej një tufë flokësh. Me cilin element të kulturës kemi të bëjmë në këtë rast? **1 pikë**
- A) Etnocentrizëm
  - B) Simbol kulturor
  - C) Ksenocentrizëm
  - D) Difuzion kulturor
2. Xhubleta (veshje tradicionale e Shqipërisë), është pjesë e listës së trashëgimisë kulturore të UNESCO-s. Me cilën pjesë të sistemit kulturor lidhet xhubleta? **1 pikë**
- A) Vlerat
  - B) Normat
  - C) Kundërkulturën
  - D) Kulturën materiale
3. Trajtimi i diferencuar i banorëve me ngjyrë mbrohej me ligj në SHBA. Në fund të shekullit të XIX-të dhe në fillim të shekullit të XX-të në rajone të veçanta u zbatuan ligjet "Xhim Krou", që aplikonin ndarjen racore. Në sociologji kjo praktikë quhet: **1 pikë**
- A) diskriminim pozitiv.
  - B) asimilim përshtatës.
  - C) stereotip paragjykes.
  - D) diskriminim institucional.
4. Në një shoqëri globale, intensifikohen marrëdhëniet politike, tregtare etj. Bashkëpunimi në këtë rast pengohet nga psikozat e: **1 pikë**
- A) etnocentrizmit.
  - B) vlerave universale.
  - C) relativizmit kulturor.
  - D) vlerave nënkulturore.
5. Shoqërizimi është një proces i domosdoshëm dhe i vazhdueshëm. Sipas sociologut Çarls H. Kuli ky proces lidhet me: **1 pikë**
- A) formësimin e vetëdijes bazuar në përkatësinë gjinore.
  - B) marrëdhënien ndërmjet instinkteve dhe vetëdijes njerëzore.
  - C) krijimin e identitetit personal pa ndikimin e faktorëve të jashtëm.
  - D) ndërveprimin shoqëror që aftëson njerëzit të marrin rolin e tjetrit.
6. Shumë komunitete emigrantësh në SHBA, me kalimin e kohës, përdorin anglishten si gjuhën kryesore në shtëpi dhe jo gjuhën amtare. Ky proces i përdorimit të gjuhës dominuese të vendit pritës ilustron konceptin sociologjik të: **1 pikë**
- A) etnicitetit.
  - B) asimilimit.
  - C) pluralizmit.
  - D) diskriminimit pozitiv.
7. Shpeshtimi i diskutimeve për një gamë çështjesh që trajtojnë pluralizmin dhe tolerancën nga perspektiva kulturore, janë tipare të shoqërisë: **1 pikë**
- A) moderne.
  - B) industriale.
  - C) tradicionale.
  - D) pasmoderne.

8. Sociologu amerikan Uajt studioi komunitetet e rrugës në vitet 1940. Ai iu bashkua dhe fitoi besimin e tyre duke studiuar drejtpërdrejtë dinamikën sociale të grupeve të marginalizuara.  
Përcaktoni metodën e kërkimit sociologjik të përdorur. **1 pikë**
- A) Anketa  
B) Intervista  
C) Vëzhgimi  
D) Eksperimenti
9. Në fushën e telekomunikacionit zhvillimet janë të shumta. Disa mjekë vlerësojnë se antenat celulare janë shkaktoare të sëmundjeve të ndryshme. Në këtë rast ndryshimi shoqëror ka si karakteristike: **1 pikë**
- A) rrjedhojat kontradiktore.  
B) kohëzgjatjen e paracaktuar.  
C) qëllimshmërinë dhe planifikimin.  
D) veçoritë dalluese në çdo shoqëri.
10. Në Sri Lanka, sistemi i kastave i ndante njerëzit në kategori dhe shumica e tyre ishin të vetëdijshëm për grupin në të cilin bënin pjesë. Kjo shoqëri karakterizohej nga: **1 pikë**
- A) lëvizshmëria sociale.  
B) lëvizjet revolucionare.  
C) nivele të larta të meritokracisë.  
D) mungesa e lëvizshmërisë sociale.
11. Në kulturën tradicionale shqiptare në ceremoni gëzimesh mbizotëronte ngjyra e kuqe në veshjet e grave.  
Përcaktoni ç' lloj norme është dhe shpjegoni një tipar të saj. **2 pikë**
- Normë: \_\_\_\_\_
- Shpjegimi: \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
12. Shkolla ka krijuar ekipin e debatit me përfaqësues nga klasa të ndryshme. Anëtarët e ekipit bashkëpunojnë për temat sociale, politike, ekonomike. Nxënësit realizojnë prezantime duke respektuar rregullat dhe parimet etike në një debat.  
Bazuar në shembullin e dhënë, shpjegoni tre funksione që realizon shkolla në procesin e shoqërizimit. **3 pikë**
- 1) \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
13. Në studimet sociologjike fundamentalizmi fetar përcaktohet si organizatë fetare konservatore. Fundamentalizmi ka një prirje për t'u aktivizuar përgjatë procesit të shekullarizimit si kundërvënie ndaj tij. Shpjegoni tre arsye pse ndodh një gjë e tillë. **3 pikë**
- 1) \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

---

**14.** Aktivistja Bell Huks deklaronte se: “Të menduarit feminist na mëson ne, veçanërisht, si të duam drejtësinë dhe lirinë në mënyra që kujdesen dhe mbështesin jetën.”

Bazuar në feminizmin si lëvizje shoqërore dhe politike, përcaktoni katër objektiva:

**4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**15.** Nga analiza e të dhënave të Sondazhit të Vlerave Botërore, rezulton se banorët e zonave urbane me popullsi të dendur kanë nivele më të larta të tolerancës krahasuar me banorët që jetojnë në zonat rurale.

Analizoni tre faktorë ndikues që mbështesin këtë përfundim.

**3 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**16.** Në shoqëritë më të industrializuara puna ka disa tipare dalluese. Revolucioni i informacionit ka ndryshuar shumë proceset e punës. Analizoni tre drejtime të ndryshimit që ka sjellë përdorimi i teknologjisë së informacionit në proceset e punës.

**3 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**17.** “Neonazizmi, fashizmi, racizmi dhe çdo veprim antihuman,... është manifestim- shprehja e bishës, që ne të gjithë kemi brenda nesh, pa asnjë ndalesë gjatë rritjes së saj, atëherë kur rrethanat politike dhe sociale ndihmojnë dhe përforcojnë praninë e tij barbare dhe çnjerëzore. I vetmi kundërhelm për të luftuar bishën është edukimi.”,- shprehej M. Haxidhakis.

Bazuar në këtë perspektivë shpjegoni:

**2 pikë**

Si ndikon shoqërimi në formimin e personalitetit?

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Si ndikon në shoqërim programi mësimor i fshehtë?

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

---

## Filozofi

18. Filozofia e stoikëve mbështetet në idenë, se ngjarjet ndjekin rrugën e tyre bazuar në ligjësi universale. Sipas tyre, njeriu nuk e ka në dorë atë çfarë ndodh rreth tij, por mund të gjejë paqen dhe harmoninë shpirtërore përmes: **1 pikë**
- A) çlirimit të ndijimeve njerëzore.
  - B) lirisë në zgjedhjen e dëshirave.
  - C) gjykimeve të bazuara në emocione.
  - D) kontrollit të pasioneve përmes arsyes.
19. Në përpjekje për të provuar ekzistencën e Zotit, njerëzit kërkojnë shpjegim për praninë e së keqes në botë. Cili filozof u përpoq ta shpjegonte këtë paqartësi, me arsyetimin se e keqja është mungesa e Njeshit ose përsosmërisë? **1 pikë**
- A) Plotini
  - B) Seneka
  - C) Protagora
  - D) Mark Aureli
20. Kampanela synonte ndërtimin e një shoqërie ideale, në të cilën të gjithë janë të barabartë dhe ku nuk ekziston prona private. Pikëpamjet e Kampanelës konsiderohen: **1 pikë**
- A) realiste.
  - B) utopiste.
  - C) anarkiste.
  - D) reformiste.
21. Çdo periudhë historike ka veçoritë e saj dalluese. Një nga tiparet kryesore të Mesjetës ishte përpjekja e mendimtarëve për t'i hapur rrugë dijes filozofike përmes: **1 pikë**
- A) ndërgjegjes dhe besimit të lirë fetar.
  - B) zhvillimit të dijes së vërtetë shkencore.
  - C) ndërthurjes së filozofisë me teologjinë.
  - D) lirisë së mendimit filozofik dhe politik.
22. Edukimi i brezit të ri ka qenë dhe mbetet detyra më e rëndësishme e shoqërisë. Sipas Rusoit, arsimimi i të rinjve duhej të bazohej tek: **1 pikë**
- A) metodat autokratike të mësimdhënies.
  - B) detyrimet lëndore brenda programeve.
  - C) zhvillimi i vlerave dhe prirjeve personale.
  - D) bindja ndaj autoritetit absolut të mësuesit.
23. Shekulli i XVIII-të ishte epoka e ideve të mëdha përparimtare dhe iluministe, ku mendimtarë të shquar ndriçuan mendjet e njerëzve dhe i hapën rrugën progresit të shoqërisë. Tipari dallues i kësaj periudhe ishte: **1 pikë**
- A) mbështetja te miti dhe feja.
  - B) dominimi i ideve skolastike.
  - C) mosbesim në dijen shkencore.
  - D) përhapja e arsimit dhe diturisë.
24. Filozofët mbështesin qëndrime të ndryshme lidhur me besimin në fuqitë e mbinatyrshme dhe në jetën përtej vdekjes. Henri Bergsonit është dualist, pra ai beson se: **1 pikë**
- A) trupi dhe shpirti janë një realitet i vetëm.
  - B) trupi dominon shpirtin dhe e drejton atë.
  - C) shpirti zhduket bashkë me trupin pas vdekjes.
  - D) shpirti është i pavdekshëm, i pavarur nga trupi.

25. Sukses në rrethana të caktuara varet nga mënyra e të shprehurit dhe fjalori i përdorur në përputhje me situatën. Për Ludvig Vitgenshtajn gjuha si "lojë gjuhësore": **1 pikë**

- A) nuk ka një strukturë logjike, që përputhet me realitetin.
- B) është e ndarë nga realiteti i përditshëm dhe i zakonshëm.
- C) mund të shpreh vetëm nivelin më të lartë të mendimit njerëzor.
- D) është praktikë shoqërore për të komunikuar qartë dhe efektivisht me të tjerët.

26. Sipas Marksit, historia ecën përpara përmes zgjidhjes së kontradiktave, nga një rend më i ulët ekonomik-shoqëror, në rend të ri më të përparuar. Cila do të ishte rruga e duhur për këtë ndryshim, sipas tij? **1 pikë**

- A) Revolucioni me dhunë i proletariatit.
- B) Kompromisi me klasën e borgjezisë.
- C) Evolucioni gradual social dhe kulturor.
- D) Ndryshimet paqësore brenda sistemit kapitalist.

27. Dija njerëzore është ruajtur e dokumentuar në tekste shkencore, duke shërbyer si përvojë për brezat e rinj. Enciklopedistët francezë të shekullit të XVIII-të, vlerësuan zhvillimin e njeriut përmes: **1 pikë**

- A) shkencës, moralit dhe artit.
- B) dominimit të dogmave fetare.
- C) traditës kulturore të së shkuarës.
- D) nënshtrimin ndaj autoritetit të shtetit.

28. Mendimi filozofik në Greqinë e lashtë lindi si përpjekje për të shpjeguar natyrën dhe qenien njerëzore. Përshkruani tre tipare që karakterizojnë mendimin filozofik. **3 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

29. Në kohë krizash social-ekonomike, dija filozofike bëhet udhërrëfyese për të lehtësuar rrugëtimin e jetës. Filozofia e Epikurit pati si qëllim t'iu tregonte njerëzve mënyrat për të qetësuar shpirtin dhe për të jetuar të lumtur. Shpjegoni tri mënyra sipas Epikurit. **3 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

---

**30.** Shteti është një organizim i domosdoshëm për të rregulluar marrëdhëniet e individëve në shoqëri. Sipas Hobsit shteti u krijua si marrëveshje për të mbrojtur të drejtat. Mbështetur në mendimin e filozofit, shpjegoni katër funksione të shtetit që krijohen në kushtet e kontratës sociale. **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**31.** Në përballje me vështirësi të ndryshme ekonomike, sociale, shëndetësore, etj., njerëzit po humbasin ekuilibrat në shoqëri. Arsyetoni dy mënyrat e mëposhtme që sipas filozofisë ekzistencialiste të Zhan Pol Sartrit të ndihmojnë të vendosësh një raport më të drejtë mes vetes dhe të tjerëve. **2 pikë**

Njeriu si qenie për veten \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Njeriu si qenie për të tjerët \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Mbani qëndrimin tuaj: Roli i individit në shoqëri dhe raporti me të tjerët. **2 pikë**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**32.** Në filozofinë e Shën Akunit vihet re ndërthurja e besimit me arsyen. Ai u mundua të kapërcente kundërshtinë mes besimit fetar dhe dije filozofike. Vlerësoni tre momente të integritit të besimit dhe arsyes bazuar në pohimin e tij: "Të kemi besim tek arsyeja, t'i japim rëndësi përvojës, por pa u shkëputur nga ideja e Zotit krijues". **3 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

---

**33.** Mbetet shumë aktual në ditët e sotme arsyetimi i Monteskjesë, se për të shmangur arbitrarizmin, çdo shtet brenda organizimit të tij, duhet të përbëhet nga tri forma të pushteteve: legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Analizoni raportin e tre pushteteve mes tyre që shteti të funksionojë siç duhet, sipas filozofit. **3 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_